



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 21.02. 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I Mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe
Mbiqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mosilović, zëvendëskryetar i dytë, Xhelal Sveçla, Drita Millaku, Ismet Beqiri, Muharrem Nitaj dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Munguan: Fatmir Xhelili, Ramiz Kelmendi dhe Shemi Sylaj

Deputetët e tjerë pjesëmarrës në takim: Milaim Zeka dhe Teuta Haxhiu

Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme: Ministër i Punëve të Brendshme-Flamur Sefaj, Fitim Tahiri-Auditor i Brendshëm-Njësia e Auditimit në MPB, Shaban Guda-Drejtor i Departamentit për Kufirin-Policia e Kosovës, Dardan Kocani-Drejtor i Departamentit për Integritet Evropian, Mërgim Himaj-Udhëheqës Dëvizi i hartimit dhe harmonizimit të legjislativës në MPB.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Drita Perezic-ICITAP,
Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e komisionit të mbajtura me datë 23.01.2018 dhe 29.01.2018;
3. Raportimi i Ministrisë të Punëve të Brendshme, z.Flamur Sefaj, rreth zhvillimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës;
4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin Nr.06/L-014 për Infrastrukturë Kritike;
5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-214;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen. Kryesuesi theksoi se do të kryesoj mbledhjen deri në ardhjen e Kryetarit të Komisionit, z.Haxhi Shala

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

Komisioni me një abstenim dhe e miratoi rendin e ditës, duke shtuar pikën e gjashtë(6) si në vijim: Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e komisionit të mbajtura me datë 23.01.2018 dhe 29.01.2018.

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin Nr.06/L-014 për Infrastrukturë Kritike.

Kryesuesi, theksoi se grupi punues ka përfunduar të gjitha procedurat ndërsa raporti me rekomandime do të procedohet për lexim të dytë në seancë. Por theksoi se nga Komisioni për Integritet Evropian, është propozuar që Amendamenti i parë i propozuar nga Komisioni(Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., fjala i “rëndësishëm” zëvendësohet me fjalën” “konsiderueshëm”) të mos procedohet, me qëllim të transpozimit të plotë të direktivave të BE-së, dhe të mbetet siç është në tekstin e projektligjit.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet raporti me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-014 për Infrastrukturë Kritike, me përjashtim të Amendamentit të parë (Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., fjala i “rëndësishëm” zëvendësohet me fjalën “konsiderueshëm) dhe procedohet për lexim të dytë në seancë plenare dhe rekomandon votimin etyre.

4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligji nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-214.

Kryesuesi, theksoi se edhe për Projektligji nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-214 janë kryer të gjitha procedurat dhe është i gatshëm të procedohet për lexim të dytë në seancën plenare. Gjithashtu theksoi se për këtë Projektligj nga ana e Komisionit është propozuar Një(1) amendament ndërsa nga Grupi Parlamentar “Lisat Serbe” janë paraqitur gjashtë(6) amendamente, të cilat pa përkrahjen e Komisionit janë të përfshira në raport dhe do të procedohen në seancë.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me me një abstenim(Zoran Mojsiloviq) nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet raporti me propozim-amendamentin e Komisioni funksional për Projektligji nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-214 dhe procedohet për lexim të dytë në seancë plenare dhe rekomandon votimin e tij.

5. Raportimi i Ministrit të Punëve të Brendshme, z.Flamur Sefaj, rreth zhvillimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës.

Kryesuesi, theksoi se nga ana e ministrit z.Sefaj, është kërkuar që raportimi në Komision të bëhet pa prezencën e medias. Për këtë arsye propozoi që kjo çështje të hidhet në votim.

Muharrem Nitaj, propozoi që një pjesë e raportimit ku nuk do të cenoheshin hetimet, të bëhen në prezencën e medias, ndërsa pjesa tjetër e cila mund të konsiderohet më e ndjeshme të bëhet pa prezencën e medias. Gjithashtu shtoi se e konsidero të pa arsyeshme që mbledhja të jetë e mbyllur, pasi është më e arsyeshme që opinioni të dijë se çfarë është duke ndodhur dhe pa përmendur emra.

Rexhep Selimi, vlerësoi se pajtohet me z.Nitaj, që raportimi mund të bëhet në dy pjesë, ku njëra të ishte e hapur për media ndërsa pjesa tjetër jo, duke shtuar që do të varet nga Ministri se cilat informacione i ndan në pjesën e parë dhe të dytë.

Kryetari, theksoi se me kërkesën e Ministrit, është kërkuar që raportimi të jetë me dyer të mbyllura. Gjithashtu theksoi se ka arsye nga ana e Ministrit pse është kërkuar të jetë pa media.

Zoran Mojsilović, theksoi se pajtohet me Ministrin, që pjesa kur të raporton ai të jetë e mbyllur dhe pa media, në mënyrë që të ndihen më të lirshëm.

Milaim Zeka, theksoi se mbështet idenë e Ministrit që takimi të jetë e mbyllur, pasi do të ishte më e arsyeshme, duke shtuar që ka për të prezantuar edhe disa dokumente lidhur me këtë çështje.

Ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj- theksoi se janë disa çështje që janë të ndjeshme dhe mund të interferojnë në procesin e hetimit, duke shtuar që për të pasur një takim sa më efektiv, takimi të jetë i mbyllur.

*Sipas kërkesës së Ministrit të Punëve të Brendshme, z.Flamur Sefaj, mbledhja e Komisionit do të vazhdoj të mbahet pa prezencën e medias dhe monitoruesit prezent të punës së Komisionit.*¹

6. Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Kryetari, propozoi që të formohet grupi punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

1. Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.
2. Grupi punues ka këtë përbërje: Rexhep Selimi-raportues, Zoran Mojsilović, Fatmir Xhelili, Muharrem Nitaj, Ismet Beqiri, Xhelal Sveçla, Bahrim Shabani anëtarë.
3. Secili anëtarë i Komisionit sipas interesimit mund ti bashkëngjitet Grupit punues gjatë punës së tij.
4. Grupi punues në bashkëpunim më Njësinë koordinuese të Komisionit harton Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

¹ Pasi pjesa kur ka raportuar Ministri i Punëve të Brendshme, ka qnë me dyer të mbyllura, pjesa ku raporton Ministri si dhe diskutimet me anëtarët, nuk është e përfshirë në procesverbal. Inqizimi audio është në dispozicion në zyrën e stafit mbështetës.

Rexhep Selimi, theksoi se pasi u formua grupi punues, me fillimin e javës së ardhshme të mbahet takimi i parë, duke propozuar idetë për të hartuar planin e veprimit dhe agjendën e takimeve.

4. Të ndryshme.

Kryetari, propozoi që në takimin e radhës, sipas agjendës së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, të ftohet në raportim në Komision.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur

Mbledhja përfundoi në orën 13:15

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala